


BIBLIOTEKA
SHTETIT

8H-1
K 30

Mauricio Kaprile



NE KËTË GJI DETI

8H-1
K 30

Mauricio
Kaprile

NË
KËTË
GJI
DETI



poezi

I përktheu nga origjinali Andrea Varfi

SHTËPIA BOTUESE «NAIM FRASHËRI»

Kaprile, M.

Në këtë gji deti. Poezi. I përkth.
nga origj. A. Varfi. T., «Naim Frashëri»,
1979.

92 f.

B-ka të mëdha dhe

B-ka të vogla: 850-1

K 30

Tirazhi 3000 kopje

Format 70x100/32

Stash: 2204-72

KOMBINATI POLIGRAFIK — Shtypshkronja e Re
Tiranë, 1979

PARATHËNIE

Emri i poetit italian Mauricio Kaprile nuk është i panjohur për lexuesit shqiptarë. Në shtypin tonë janë botuar disa nga poezitë, që atij i ka frymëzuar realiteti i ri i Shqipërisë. Ato janë mirëpritur ndër ne dhe janë përfshirë edhe në përmbledhjet e tija poetike në Itali, duke tingëlluar edhe si një notë e re, e veçantë në krijimtarinë e tij poetike. Synimi i kësaj përmbledhjeje (në të janë përfshirë krijime dhe fragmente krijimesh të zgjedhura nga katër vëllimet e botuara gjer tani prej Kapriles, duke filluar nga viti 1971: «Djegur nga dielli», «Tubim resh», «Një prazhdë jete», dhe «Poezi») është që lexuesit tanë të njihen më afër e më gjerë me këtë poet të talentuar përparimtar antifashist, që qysh në moshë të re mori pjesë me armë në dorë, si komisar batalioni par-

tizan, në luftën për çlirimin e popullit të vet nga nazi-fashizmi. Në një Mbrëmje Akademike, zhvilluar më 9 dhjetor të vitit që shkoi në Romë, Kaprile u rradhit nga Instituti i Lartë Ndërkombëtar i Studimeve Humaniste midis atyre poetëve që morën titullin «Poet më i mirë i vitit 1978».

Jo pa qëllim, siç del e qartë nga sa pohuam më lart, kemi renditur në krye të kësaj përmbledhjeje poetike pikërisht motivet nga periudha e Rezistencës Antifashiste.

Duke shprehur dëshirën e sigurtë për heroizmin, për një ideal, poeti i drejtohet kështu «Një heroi»:

Ishe në gjithë gojët e njerëzve,
ishe
në të gjitha tytat e pushkëve,
ishe i vdekur
dhe ishe i gjallë...
Ishe ati, mëma, vëllai, motra ime:
ishe ideali im.

«Ishe ati, mëma...». Poeti nuk ishte jetim në ato kohë të vështira, plot sakrifica e vuajtje, por heroike. Kujtimet e jetës partizane janë të gjalla në poezinë e Kapriles. Ne qëndrojmë bashkë me poetin në atë kasollen strehë të partizanëve. Ne i shohim karvanet me dhuratat për Rezistencën, që i dërgojnë njerëzit e vendlindjes së tij Imperia. Ne ëndërrojmë bash-

kë me të për fitoren dhe rijetojmë tronditjen e poetit të ardhshëm, kur shokët e njoftojnë: «Mbaju si burrë, të arrestuan mëmën» nazifashistët («Për një çast», «Kasolle», «Dhurata për Rezistencën», «Grabujim»). Ne admirojmë ata «pak njerëz», që «ngjiten në majë, / që mos t'u erren sytë», që të mos bëhen qorra si ata që dezertonin, sepse të pakalitur nga një ideal. Shembulli i kësaj rezistence të dëshpëruar, të vendosur, është frymëzues («Të pamposhturit»).

Dhe ja, ndër shpate malesh, lëshojnë dritë zjarret partizane «për të nderuar dhe mos harruar / jetën». Ne na trondit përfytyrimi i shokëve, që nazistët i kanë varur, «i kanë kolovitur... / ndër degë dru-rësh» («Flakadanë»). Porse më tronditës është mendimi që buron nga krijime të tjera të poetit: përse këto sakrifica të rënda?.. Nga njëra anë poeti ngazëllohet që «pushkët gati të mbrojnë lirinë / u bënë një pyll i madh», por, në të njëjtën kohë, atë nis ta brejë dyshimi për të nesërmen, sepse «insektet brejtëse janë veshur si njerëz! / Nesër / insektet do të nisin ta gërryejnë / kaltërsinë e këtij qielli të ri» («Fitimtarët»).

Tronditja dhe vuajtja përpara tradhtisë revizioniste i ka frymëzuar poetit atë «Bërthamë vreri», ku më qartë e më fuqishëm se kudo ai godet ish-luftëtarin komunist, që i braktisi «majat e mprehta të fitores», që pati frikë dhe u ul «këmbëkryq në shesh», që s'i deshi «fashat e kuqe të agimit»... «Ne s'i de-

shëm», — shfren vetë poeti, duke e ndier edhe përgjegjësinë e vet si militant komunist i Rezistencës. Ata, revizionistët, tradhtuan, se qenë njerëz që e braktisën aksionin revolucionar, u bënë «një grumbull prapanicash ngjitur për karrigesh».

«Ishe ati, mëma...» — i drejtohet me të drejtë poeti heroit, që edhe i vdekur mbetet i gjallë. Tani, me një klithmë dhimbjeje e dëshpërimi, ai thërret: «nuk kam më as atë, as mëmë!». Degjenerimi ka ardhur shkallë-shkallë: ai, që dikur ftonte për beteja e që pastaj komandon vetëm me sy, më në fund «hesht dhe më nuk komandon, / as dhe me sy», sepse tashti ai është «memec» e «i shurdhër», ai është «asgjë». Ai tashti, edhe pse i gjallë, është i vdekur.

Mauricio Kaprile, i cili në kritikën italiane është cilësuar me të drejtë si një poet në kërkim të së vërtetës (siç mund të vërehet edhe në krijimet e radhitura në këtë përmbledhje — dëshmi e këtij kërkimi të mundimshëm, që i shkakton atij shumë dhembje e vuajtje), hap pas hapi, përmes eksperiencash jetësore dhe meditimesh, arrin të shohë gjithnjë e më qartë dhe të shprehë përherë e në mënyrë më konkrete në poezinë e vet realitetin që e rrethon dhe kredon e vet poetike.

Ai i sheh qartë «idealet — ndotur nga kompromisi» («Kongres ndër ne»). Sepse revizionistët i kanë braktisur idealet e Rezistencës. Për poetin janë të pafalshëm «llafazanët», por po aq të pafalshëm janë

edhe «gojëkyçurit». Duke rënë në mendime në poezinë që mbyll vëllimin «Në këtë gjë deti», Kaprile shpall kredon e vet: «nuk duhet t'u bëjmë bisht / gëzimeve dhe hidhërimeve të jetës».

Ai kërkon, me mundim, një lidhje me tokën e vet dhe e identifikon veten me të. Natyrën ai e quan «dashnorja ime e zjarrtë edhe e përhershme» («Në luginën time»). Dhe kthehet me mirënjohje tek malet e vendit të vet («Male»).

Duke lexuar poezinë e Kapriles nuk është vështirë të hetohen menjëherë qartë zhgënjimet torturose për të. Ndaj ëndërron diçka të qëndrueshme e të përjetshme siç është thirrja ngazëllimtare e fëmijëve, siç janë natyra dhe dashuria. Atij i fanitet gjithnjë një «Qiell korriku» mbi qytetin e tij të dashur, Livornon, ku nata çohet «syulët porsì vashë». Dhe ëndërron diçka të pastër, të virgjër, të papërdhosur nga realiteti i rëndë i vendit të vet dhe jo vetëm i vendit të vet. Në kontaktin me tokën, atë e pushton dëshira të bëhet NJERI me shkronja të mëdha («Lulet»).

Në poezinë e Kapriles është gjithnjë e pranishme vuajtja tronditëse që i shkaktton ky realitet i rëndë. Shkëmbinjtë në bregun e Livornos së tij i frymëzojnë pikërisht «përmendore / viganësh në pranga, të dëshpëruar» («Në Livorno»). Pra: dhembje deri në dëshpërim. Ai përmend edhe trupin e vet të sëmurë, vitet fill pas mbarimit të Luftës së dytë Botërore, kur, vetë invalid lufte, u muar një kohë të gjatë me problemet

e ish-luftëtarëve të Rezistencës, duke u bërë edhe Sekretar i Përgjithshëm i «Shoqatës Kombëtare të tuberkulozëve të Luftës» dhe sekretar i redaksisë së revistës «Lufta antituberkulare». Por atë e trondisin jo vuajtjet personale. Atë e trondit kuadri makabër i njeriut të braktisur, njeriu i kthyer në kufomë në shkallët e një kishe, ndërsa statujat zotërojnë she-shin e qytetit («I braktisur»). E pra poeti ka luftuar për një jetë më të mirë. Poetin e mundojnë, në radhë të parë, vuajtjet e botës. Ai, i etur për jetë dhe për drejtësi, mendon shumë për fatin e njerëzimit. Për të pemët janë «vrojtorët më të madhërishtëm të vuajtjeve të botës» («Male»). Poetin e preokupon fati i brezave që vinë. Përmes dialogut babë e bir shtrohet problemi për të zgjedhur midis gjelbërimit dhe verdhësisë së arit. Por djali jep një përgjigje të prerë: «e flaka tej arin, o atë / edhe kam mbetur mbushur gjelbërim», edhe pse «më rrahën, o atë, se isha plot përplot me gjelbërim» («Breza»).

Nga vëllimi në vëllim përherë e më shumë Mauricio Kaprilen e pushton dëshira për të rigjelbëruar shpirtin. Përmes luhatjeve shpirtërore të poetit, ne shohim, megjithatë, ngjyrën e kuqe të qiellit «sikur të ishin bashkuar në atë ngjyrë / gjithë shpresat e njerëzve» («Në këtë gji deti»). Ai tejkalon, përherë e më me guxim e më me qartësi, vetminë në shoqërinë kapitaliste, lëkundjet midis guximit dhe frikës, pasqyrimin e brutalitetit e tmerrit të luftës si e tillë dhe ci-

lësimin e përpjekjeve njerëzore të kësaj bote të trazuar të pasluftës si beteja të padobishme e të çmendura. Ai çlirohet në mënyrë përherë e më të vendosur nga dëshpërimi i zhgënjimeve, nga dyshimet dhe melankolia, nga notat e mëshirës kristiane dhe perceptimet sensualiste të dashurisë. Ai braktis shqetësimet torturuese për një fund të njerëzimit dhe humbjen e shpresës për ndonjë liman të sigurtë.

Në ecjen e tij poetike përpara ai priret gjithnjë e më shumë të kalojë nga qartësia dhe saktësia e frazës, që ne e hetojmë pothuajse përherë, edhe në qartësinë dhe saktësinë e mendimit. Ai flet tashti për nevojën e një dielli, që «akullin në shpirt të grumbulluar do ta shkrinte», e një shiu, që «do të pastronte fytyrën e ndyrë të ekzistencës» («Jeta ime»). Ai ëndërron të shkrijë dëbora ndër male dhe uji të fshijë «rrjetat e merimangave / në të gjitha zemrat e botës», që të mund të thotë: tani «i lirë të rritesh, gjelbërim!» («Shpresa»). Me fantazinë e poetit ai përfytyron kohën kur të gjithë «do të mbërthehen dorë më dorë» dhe të gjithë «do të vallëzojnë me kryet lart drejt qiellit» («Toka»). Poetin Mauricio Kaprile e entuziazmon barra e rëndë që kanë ngarkuar mbi shpatulla ndër-tuesit e rinj në Elbasan, njeriu i ri i Shqipërisë revolucionare.

Poeti italian Mauricio Kaprile është një mik i sinqertë i popullit tonë, përkthyes dhe propagandues i poezisë sonë të re të realizmit socialist, përkrahës ak-

tiv i Shqipërisë socialiste, të cilën ai e ka vizituar disa herë.

Motivët nga Shqipëria ai i ka botuar për herë të parë më 1974, në përmbledhjen të cilën e pati titulluar «Një prazhdë jete». Kontakti me realitetin krejt të ri revolucionar shqiptar e hodhi poetin, si me një prazhdë, me një hobë, në krahët e një jete të panjohur më parë prej tij, e një jete të gjallë, me njerëz të rinj e të lumtur, që këndojnë për punën e për revolucionin, edhe kur bëjnë një punë që kërkon shumë mund e djersë. Për të «takimi me njerëz kaq të gjallë / është takimi më i rrallë» («I këndojnë punës dhe revolucionit»). Poeti preket kur vullnetarët për ndërtimin e hekurudhës i dhurojnë një shami aksioni me drapër e çekan. Ai flet me entuziazëm për shkatërrimin e shenjtorëve, për katedralen të shndërruar në Shkodër në stadium («Shkodrës së blertë»). Duke përmendur se në stadium ka mbetur vetëm tavanin, për të na kujtuar «të djeshmen mistike», Kaprile përfundon: «me mendje e çava tavanin / dhe pashë hapësirat qiellore». Kjo dalje në qiell të lirë u kundërvihet disa motiveve të mëparshme të poetit, që i përmendëm më lart. Duke qëndruar midis rinisë shqiptare ai e ndien se po kthehet në rininë e tij, kur merrte pjesë aktive në lëvizjen e Rezistencës Antifashiste. Në Elbasan të rinjtë aksionistë «me drapër-e-çekanët ndër sy» i propozojnë poetit të qëndrojë me ta. Ai u përgjigjet se atë e presin në vendin e tij dhe, duke u

zhytur ndër mendime të hidhura, «në vend të ulërimës buzëqesh» («Njeriu i ri»). Aq kontrastues i ngjan realiteti i të dy vendeve. Në Vlorë poeti ndien jo vetëm të sotmen, por edhe të kaluarën e Shqipërisë. Ai ndien praninë e Ismail Qemalit dhe mbrëmjeve «Skënderbeu kalorës i yjeve vigjilon» («Shëtitorja e portokalleve»-. Duke vizituar Krujën, duke udhëtuar anembanë Shqipërisë, ai nxjerr përfundimin se gjithë ata që kanë synuar ta gjunjëzojnë Shqipërinë, ta shembin kështjellën shqiptare, kanë thyer vetë kokën. Poetin, në vjershën «Shëtitorja e portokalleve», e sugjestionon figura e udhëheqësit të Partisë dhe të popullit shqiptar: «Unë eci dhe përpara meje / prin një Enver Hoxhë vigan».

Duke shfletuar faqet e këtij libri poetik, ne ndiejmë gjithnjë rrahjet e një zemre fisnike, të shqetësuar, ku vibron dëshira për një ideal të lartë, rrahjet e një zemre në thelb të zjarrtë dhe plot dashuri për Atdheun e vet e për njerëzimin, për njeriun e vërtetë, për gruan dhe për natyrën, e një zemre plot ëndrra poetike dhe, në të njëjtën kohë, të mbushur plot zemërim kundër atyre që i tradhtuan idealet.

Prej këtij vëllimi poetik, ku janë përfshirë nga krijimet më përfaqësuese dhe më të avancuara poetike të Mauricio Kapriles, shqipëruar me dashuri dhe respekt për autorin nga poeti Andrea Varfi (në vëllim janë përfaqësuar me përkthime edhe poetët Dritëro Agolli, Ismail Kadare e Fatos Arapi), ne shohim qartë

se poeti i sotëm italian Kaprile synon në poezinë e vet diçka autentike, të vërtetë, të ashpër, të natyrshme e të singertë. Ai poezinë e kërkon me ankth e me mundim. Ajo për të nuk është një lodër, një pozim a kalim kohe. Është dhembja e thellë dhe shpresa e ndritshme e zemrës së tij të ndieshme. Është kuptimi i jetës së tij. Është biografia e tij.

LLAZAR SILIQI

NJË HEROI

Ishë në gjithë gojët e njerëzve,
ishe
në të gjitha tytat e pushkëve,
ishe i vdekur
dhe ishe i gjallë.

Në agim të gjenim kurdoherë më këmbë,
për të na uruar një ditë lavdie.
për dritën ndër beteja
jepnim kushtrimin me emrin tënd.
Ndër nete,
hija jote na kthente mbulojat
dhe bënte roje.

Kurrë nuk të kam parë.

Kurrë nuk të kam thënë një fjalë.
Por fytyra jote

m'i fshinte gjithë fytyrat më të dashura;
shembulli yt, —
gjithë shembujt më të bukur.
Ishe ati, mëma, vëllai, motra ime:
ishe ideali im.

TASHTI JAM NË ANËT E MIA

Në zonën e armikut: napa bari,
liqeni i përgjumur i mbylli sytë.
Shtëpi të bardha në gjysmërreth po shtrihen;
ua zgurdullon telgjembë sytë armiqve.

Unë shkas përpara qull nga shiu,
duke kërkuar vetëm zjarr e bukë,
pushim për këmbët e ngrira,
pak qetësim për mendjen time në ankth.

Një qen sulet mbi mua
pa mëshirë për barin dhe për mishin tim.
Kafshimi i tij më thotë:
qenkam i gjallë,

më i gjallë se kurrë.
Armën besnike shpejt unë e rrëmbej
edhe i djeg gishtat me të shtëna;

agresorit i hap trutë,
dhe e ndiej veten gjithnjë më të gjallë.

Veten e gjej më vonë
të kruspulluar;
gryka e pushkës ka mbetur e drejtuar
një gisht pranë tëmthave:
unë qesh nga gëzimi —
qëllimit ia paskam arritur!

Zonën armike tashmë e kam kaluar.
Jam më këmbë,
me gjysma fjalësh jap shpjegime.
Jam me shokët
e më shpien drejt makinës;
cigaren ndez
me shkrepjen që ata më japin.
i shtrirë në vig, tashti pushoj,
përkëdhel këmbët dhe shtrij krahët;

flas, flas e sërish flas
për riininë time terr.

Tashti jam në anët e mia:
dhe malet më shikojnë,
unë jam me shokët dhe jemi bashkë;
një forcë më e fortë se armët.

DHURATA PËR REZISTENCËN

(Dhjetor 1944)

Vargan i gjatë mushkash dallgëzojnë
mbi kreshtën e malit.

Shtegu i pret si gardh.
Dhe lugina i përpin
me barrën e rëndë të tyre.

Shenja, zëra, thirrje
lajmërojnë arritjen e varganit:
vijnë nga deti i Imperias,
vijnë nga njerëzit e Imperias
dhurata
për Rezistencën.

Dhe dimri
ndërrohet për një çast
në prag pranvere, përqethëse, buçimtare,
dhe për një çast

17



stina e re
bën të shpërthejë gjak edhe nga drurët —
të vrenjtur, të kërrusur, të drobitur.

Dhe një blerim i plotë fantazmagorik
u kundërvihet për një çast
ngjyrave të zbehta të natyrës,
që, ashtu si ne, ndalet
të mbyllë plagët e saj,
që shpejt të rritet, të rritet
shëndetbuçitës,
ashtu si fitorja jonë.

K A S O L L E

Kasolle e ftohtë,
u bëre e ngrohtë
nga shkurret përpirë prej flakës.

Kasolle,
strehë e Rezistencës,
vatër e çati e vojtjeve tona,
bylmyer me borë edhe patate të paziera.

Shkëmbim mendimesh
për një të ardhme
që është e pranishme,
për një jetë
që sot është vdekje!

Kasolle e ftohtë
dhe pastaj e ngrohtë,
ke qenë dashnorja më shpirtmadhe e jetës sonë.

PËR NJË ÇAST

Një flakadan i madh
u ngrit këtë mbrëmje në pyll.

Një kuitje e ëmbël
depërtoi në trungun e pemëve.

Bora u shkri
për t'u kthyer në ujë për t'u pirë.
Nxehtësi, muzikë, ujë
dhe pak ushqim nga kasollja e bjeshkës.
Dhe për një çast
u kthyem në shtëpi:
për një çast...

Por krisma armësh
andej nga lugina
papritur na shkundin nga ëndrrat.

Një zë
buçet si krismë pushke:
«Të gjithë në marshim!»

GRABUJIM

(fragment)

Në Imperia

Tehu i veriut frashnjet po i grin;
kruspull i bërë buzëve të shkëmbit,
drithtëron myshkun;
rrufit bulzën e fundit që lë shiu
hardhi e hirtë.

Një pritje vdekjeje zotëron në shpellë:
ka nisur grabujimi¹⁾.
Aq breshëri ndaj kreshtës,
pyllit të madh dhe shpellave mbujake!

Me qentë ata vërshuan,
çrrënjosin bimë,
mbi drurët shtien.

Kërkojnë partizanin,
«banditin»,
kërkojnë mua, që pres n'ankth...

1) Grabujim = operacion spastrimi.

Shtien brenda shpellës verbas:
janë një duzinë gjermanësh,
që frikës së tyre mburojë i nxjerrin plumbat.
Dhe unë dalëngadalë e drejtoj armën
dhe përmbys një e dy,
vërvit një bombë,
dhe vriten të tjerë.

Dhe aq jetë i përgjunjen simes,
dhe aq gjak i falet gjakut tim.
Krenaria i mbyt drojtjet e mia
dhe fluturoj ndaj një strehimi tjetër.

Bie nata, dhe unë mbi bar shtrihem i lehtësuar.
Një përkëdhelje në faqet më zgjuan,
dy sy të zgurdulluar të përlotur,
më shkundin më shumë se dy duar,
një gojë e zëri i mikut që më thotë:
«Mbahu si burrë, të arrestuan mëmën!»

TË PAMPOSHTURIT

Pak njerëz në stinën e hidhur
ngjiten në majë,
që mos t'u erren sytë.

Tufa njerëzish ecin
si miza dheu, automatë,
gërmuqur mbi barin pa jetë.

Në këtë dimër,
as plafi i dëborës
nuk është i bardhë:
gjaku
e skuqi bardhësinë...

Një duzinë të pamposhtur
pranojnë bombat
si shi lulesh,
mbërthehen të gozhduar
pas tokës;
shtien breshëri

mbi monologun shurdhues
të kujt dëshiron
të shkatërrojë një ideal.
Pak vetë
të pamposhtur,
në stinën e hidhur
njerëzit përtërijnë!

FLAKADANË

Flakadanë të mëdhenj
ndër shpate malesh
pas një dite vdekjeje.

Pak fytyra kanë mbetur:
të dhimbshme,
të pikëlluara,
të pështjelluara.
Zhurmon era
dhe zjarri fytyrat përfshin;
e së largu ato duken
si pishtarë njerëzorë.

Të vdekurit ndjellin ende të vdekur:
shokët i kanë kolovitur
gjer tashti vonë

ndër degë drurësh,
të varur në ganxha për derrat.

Flakadanë të mëdhenj
ndër shpate malesh, sonte,
për të nderuar dhe mos harruar jetën!

KALLËZ GRURI

Nuk dua të vdes
duke ma marrë frymën
ngjyra e një këmishe,
i shushatur nga dër-dëre
të një predku,
i shastisur nga xixa
profkash shpellanike. .

Gjuha ime
don të gjallërojë mjegullën,
duke iu kundërvënë
grimcimeve të pakripë
të litanive të pafund të ankthit.

Zemra ime
don të vërtitet si vaj i vluar
mbi kështjellën e urrejtjes
dhe të debojave.

Vështrimi im don të tretet
në prarimin e kallëzave të grurit,
trup hapësire qiellore në agim
të secilës ditë të kalendarit
të njeriut.

F I T I M T A R Ë T

Sa zhurmë në agim dhe në muzg
të një dite
si çdo ditë.
Parfum fitorje flladiste ajrin
dje mbrëma;
siguri triumfi
shoh te dielli i sotëm...

Pushkët gati ta mbrojnë lirinë
u bënë një pyll i madh.
Por insektet brejtëse janë veshur
si njerëz!
Nesër
insektet do të nisin ta gërryejnë
kaltërsinë e këtij qielli të ri!

NJË MIKU PARTIZAN

(fragment)

Aldo Akuarones

Ti re mbi luleshqerra,
duke spërkatur me gjak tënd barin:
qielli nuk të donte,
ishe shumë i ri për krahët e vdekjes.

Kjo lufta jonë është kthjelltësi,
siç është shqota pastërti,
dhe kështu
ti më vozite në mes yjesh,
dhe unë, kur të kujtoj,
shikoj lart qiellin.

I BRAKTISUR

Të shoh të shtriquar në shkallët e një kishe,
vëren ti retë edhe fytyra foshnjash.
E kafka jote,
tek përhedh dritë nga dy sytë e zymtë,
kutërbon vdekje,
si ironia në sy kalimtarësh.

Se je i vdekur gjithë do mendonin,
po të mos shihnin dy duart e tua
tek po stërfshijnë atë tas të mjerë.
Ti nuk ke ç'thua, fati s'dashkërka
të na përzihesh dhe ti me statujat,
që zotërojnë sheshin e qytetit.

Ty nuk të duan as statujat,
ashtu siç nuk të duan ty as njerëzit,
ata që i presin rrugën
aty edhe fëmijës
tek rënd të të afrohet.

Dhe ti, duke u barkarisur, largohesh
duke shikuar tokën,
gati sikur të kërkoje të ktheheshe në pleh,
që t'i vlejë diçkaje.
Tashti ti sytë i kthen drejt fëmijëve,
ua bën me shenjë, i përshëndet,
dhe barin e thatë e shkel.

UJDHESA E ZAMBAKUT¹⁾

Bulëza të bardha,
pasoja përplasjesh në breg,
përçajnë liqenarin.²⁾
Një re rosash kërkojnë shtegun e jetës.
Palma e zhavar
voztin të shtyrë nga era.

Dhe plaku,
i ulur mbi stol,
vëren ujdhesën:
si shoqe të vetmisë së tij;
e dëgjon
si këngëtare të këngëve të rinisë së tij.

1) Isola dei gigli, në arkipelagun toskan të detit Tirren,
kundrejt malit Argentario.

2) Liqenari = laguna (it.)

Herë pas here duket
sikur po i nden krahët si një dashnoreje
aqë shumë të dëshëruar.
Pastaj ul kryet
dhe zhytet në mendime dhe kujtime.

Dy dashnorë kalojnë,
puthen dhe rendin buzëgaz
ndaj një sheshi me lule.
Një plak, një ujdhesë, një jetë.
Një erëndje trëndafili
e deh qiellin e përhirtë.

ATJE LART

Atje lart,
mes rreshtash të hardhive
të lidhur fort me tokën,
mes ngastrash të blerta
përçartur nga vlimi i vakët i pranverës,
ti, o rinia ime e hershme,
e ndalje hapin tendosur si hark,
të thithje erën e luginës,
atje m'u trete pa kuptuar.

Edhe nga ti s'më mbeti
veçse kujtimi i një stuhie,
e kremtja përpara kishës,
ca lutje latinisht,
si grimca tretur tymtoresh temjani...

S T I N Ë

Pranverë pa dallëndyshe.

Cicërima e një galdimi,
përzier me këngë gjeli,
u largua tok me çerdhet.

U zhdukën dhe balonat
nga duar fëmijësh,
ylberi mbeti i mërziur
me verën që afrohet
tagjisur nga zheg zjarri.

I zgjat ndalesat dielli
e në të verdhë e vesh qiellin,
E fluturojnë fletët
në vjeshtën e përhirtë,
dhe zogjtë e pakësuar
trishtueshëm murmurojnë,
se dimri u sjeli heshtjen.

M A L E

Ju kam lënë, male,
të palëvizshme,
si trupi im i sëmurë:
peizazhe kristalore
mbuluar nga qiej të dliurët,
mbrëmje të ngrysurë,
të qullura prej lotësh dhe prej shiu;
shtrete ethesh
dhe ushtash të mbërthyera
në gjakun tim të turbulluar.

Ju kam lënë, male,
të mëdha
si zemra e shoqes sime;
drurë besnikë,

vrojtorët më të madhërishtëm
të vuajtjeve të botës;

gurë shtigjesh të ngritur
si paterica për udhën time të mundimshme;
jehona zërash gulçimtarë
për britma të reja kremtore.

Ju kam lënë, male,
për fushën e erëkëndshme,
dhe nuk ju kam kthyer kryet,
dhe nuk ju kam thënë
<mirupafshim!>

Sot jam kthyer, male,
për t'ju falënderuar;
për të bredhur
ku nuk mundja as të ecja;
për të puthur,
ku nuk mundja as të buzëqeshja.

BËRTHAMË VRERI

Më tepër se tim eti e sime ëme ty të besoj:
më thuaj «zhduku», dhe unë s'marr frymë.
Më thirr ti natën, ditën:
të dëgjoj.

Më ço t'hedh dorën, ta vërtit, të rrah,
edhe të rrihem,
të vras, edhe të vritem!
Unë shkoj!

Ti më premtove shtëpi për të gjithë,
shkolla për të gjithë,
dhe sidomos për të gjithë lumturi.

Tashti më hesht dhe më komandon me sy,
se zëri t'u venit;
klithma e betejës,
rendja heroike, t'u venitën.

Në shpat të malit ti u ndale,
majat e mprehta të fitores ty të stepën.
Ti pate frikë;
u nanurise te këmbët e saj,
edhe m'u ule këmbëkryq në shesh.

Dhe të vërtetat fasha të kuqe të agimit
nga ti u larguan,
sepse ti s'i deshe.

Ne s'i deshëm.

Se kemi qenë një frotë burracësh,
një grumbull prapanicash ngjitur për karrigesh.
Nuk qemë të zotët të hipnim mbi tryezat,
pëlqyem kolltukët e praruar të një pushteti të rremë.
Dhe kështu nuk kam më as atë, as mëmë,
u ktheva në doç që thith bërthamë vreri,
për të mos vdekur nga uri-mërzia.

Ngandonjëherë udhëtoj në bregun tjetër,
për ta zbrazur më tepër vrerin që kam në trup.

Edhe si një gomar pëllas drejt qiellit.

Ti hesht dhe më nuk komandon,
as dhe me sy.
Ti je memec, je i shurdhër, je asgjë.

M E L A N K O L I

Prej vitesh duhej t'isha nën tokë,
i kujtuar nga fare pak miq.
Mbrëmjesh, po t'isha në ndonjë kasolle,
do strukesha pas flakëve të vatrës
dhe do të digjesha me drutë e bisedimet.

Në mes të hirit, atje do të kotesha
pa marrë ilaçe,
i purifikuar prej zjarrit.

Ka vite që jetoj veç me një buzëqeshje,
me një të rrahur krahësh,
veç me një lot, kur flamurin e ngrenë,
dhe parafytyroj gjëmime topash,
që zbrazen për nderim
të festës së fitores që nuk u arrit.

NË LIVORNO

Leshterik i kalbur
mbulon zhurin e një bregdeti
të paledhatuar prej njeriut.

Shkëmbinj për bind
frymëzojnë përmendore.
viganësh në pranga, të dëshpëruar.

Ujë që ndalet lavinash¹⁾ dhe sodit shtëpitë;
një det sedefi, që i jep perëndimet
me ngjyra të agimit.

Sheshe, rrugica, rrugë stërplot me drita e njerëz;
portikë, harkate,
mure që kërkojnë të ndalin
shqota dhe rreze dielli.

1) Lavinë — kanal

Kundërmim kripe në çdo pjesë barke,
në çdo gur qyteti.

Dhe ti e unë,
të vetëm e në mes të turmës,
vazhdojmë bisedën tonë të dashurisë.

NË MAL

Iu ngjita malit tok me shoqen time,
dhe qytetin unë e pashë të përgjunjur.

Dallgët atij i fshikullonin anët;
rrezet e diellit
atij i shponin kurm e sy.

Duke zbritur në fushë,
nga drurë psherëtimtarë i shoqëruar,
diamante e gurë të paçmuar
ndritnin mbi ujërat.

Amëz zjarri
endej me erën gjithë afsh
mbi veprat e njerëzve,
të ngurtësuar edhe të pagoja
si kujtime.

T I

(fragment)

Një vullnet i shkëmbtë,
ashtu si shkëmbi në det;
një bujari e madhe,
ashtu si zemra që ka njohur vojtjen;
një përvuajtje e drithtëruar,
si zemra që kujdeset
për fëmijën e saj;
një dëshirë për jetë,
që përbuz monotoninë
e jetës zvarranike. . .

Kjo më je ti,
o grua- shoqe e jetës sime.

QIELL KORRIKU

Karvane resh po e sulmojnë qiellin
dhe vizatojnë amfora argjendi kaltërsisë,
e ndaj perëndimit shkrirë në mavi
po çohet nata
syulët posi vashë.

Vetëm buzëqeshja e hënës që del
në qiell,
ende na sjell ndër mend
ditën-buisje drite.

Ndërkohë
yjet e para, që ndjekin njëri-tjetrin
në ëmbëlsinë e muzgut,
ngjan sikur duan të përshëndesin diellin,
që butësisht tashti është ulur
mbi shtresën që shtruar i ka deti.

TOKË E KUQE

Në Sarakenë

Tokë e kuqe
si gjaku i njerëzve.
Shtigje të ashpra
nga afshi i vreshtave
vulosur...

Një hënë që ngjan si më e afërt me tokën;
një qiell që duket sikur kërkon
të flasë për vuajtjet njerëzore;
një zagushi që të merr frymën,
si një angushti zemre.

Dhe ti je larg dhe pranë meje;
e fytyra jote më shfaqet
si shpresa ime,
me një ankth dashurie
që nuk njeh të ndalur.

Krejt rreth e qark
magjia e natyrës
kërkon motivin
e pasionit tim,
dhe toka e kuqe
jep klithma
për plagët që i janë bërë.
Sa keq më vjen që nuk të kam pranë
këtë natë nën yjet:
ty, që je ylli im.

U D H Ë T I M I

Një tren që rend,
siç rend mendimi ynë;
sërë kujtimesh
prej shfaqjesh të plota
të një lidhjeje zemrash
që s'njeh zgjidhje.

Pemë, qytete, ujëra deti,
që si shigjeta para nesh kalojnë
për të na thënë:
«Mirupafshim!»

Një shi lulesh
për çdo çast që ne së bashku po kalojmë
pranë e pranë,
për të kërkuar yllin tonë,
prijësin e sigurt të udhës sonë.

Udhë që nuk e njeh pushimin,
udhë që djeg edhe pastron çdo gjë,
për të ngritur një ndjenjë më lart,
ndjenjën që na bashkon,
edhe kërkon çdo gjë,
ashtu siç kërkon jeta.

K U L L A

Një kullë,
shenjë pushteti të lashtë,
që ujem m'i bënte ëndrrat si fëmijë,
sot para sysh m'u shfaq,
kur me gruan time bridhja
mbi bar të blertë në hije të ullinjve.

U ndala tok me gruan
dhe të tjerë,
i mposhtur nga magjia e saj e fshehtë,
u buzëqesha mureve,
të cinguarra prej kohës.

Dhe muret e lashta,
duke u përlotur,
e përshëndetën dashurinë time të lumtur.

JETA IME

Një fëmijëri,
që i sheh në dritë të shtrembër punët e botës;
një çunakëri
tepër e hershme edhe shterpë;
një djalëri
mes zjarrit të një lufte të egër:
veranda përplot me të vuajtur,
dhoma strehime njerëzish skelete,
vetmi pa fund mes pështjellimesh.

Dhe ja, papritur,
një pjekuri
ma zhurit zemrën si hekur i skuqur
dhe një dëshirë e zjarrtë
për dashuri të zjarrtë;
përbuzje
për çdo veprim,
që s'rrjedh nga një dëshirë e gjallë njerëzore.

Pastaj, gjithnjë e më e fortë
dëshira për një diell,
që akullin në shpirt të grumbulluar do të ma shkrinte,
dëshira për një shi,
që do ta pastronte fytyrën e ndyrë të ekzistencës.

TY TË PASHË

Një shkretëtirë unë e përshkova
me këmbët fshikëza, stërpjekur nga dielli.

Por një shtëpi e arrita
dhe pa këmbë:
shtëpinë tënde.

Hyra brenda dhe të pashë ty
dhe më nuk dua të kthehem nga erdha.

KËNGË MBRËMJEJE

Bregu shkëmbor, që detit ia mposht dallgët,
gëzon, e vuan,
ashtu si shpirti ynë.

Plot njerëz-hije e vërejnë ndeshjen
si krejt të rëndomtë.
Dhe vetëm fëmijët mbushen ngazëllim
nga gjithë kjo bukuri,
dhe këmbët e tyre vallëzojnë
si në një vallëzim cigan.

Kur mbrëmja bie,
gjithë sytë shkojnë
te gryka e lumit, buzë detit,
edhe shikojnë tek pasqyrohen
pemët, të etura për jetën.

Dhe ne, të zbutur nga dëshira e dashuria,
i flasim dhembjes dhe gëzimit
në qetësinë e natës,
të ulur pranë njëri-tjetrit.

KUR MË PUTH DASHURIA

fragment

Unë kërkoj e kërkoj dashurinë....

Dhe sytë i mbyll,
që t'ia ndiej thellë rrjedhën lumit.
I lirë shtriqem përmbi shkrepë,
fle mbi bar,
dhe sytë i hap i qullur krejt prej bryme.
Fytyrën unë e laj me ujërat e përrenjve
edhe e ter me rreze yjesh, rreze dielli.

I plotfuqishëm ndihem,
kur buzët m'i puth dashuria.

PËR GJITHË JETËN

Për gjithë jetën
me zjarr dëshërova
dashurinë.

Për gjithë jetën
kërkova krahë
që të më shtrëgonin,
buzë që të më puthnin,
zemra që t'i hapeshin zemrës sime.

Tashti që të kam gjetur,
unin tim e ndiej të ndryshuar,
nuk jam më unë, por jam ti,
dhe ti je unë.

N J Ë L E T Ë R

Mirupafshim, i dashur,
lavar çarçafët e tu,
qepa rrobat e tua,
hekurosakëmishat e tua.

Mirupafshim, i dashur,
pastrova kuzhinën të
rregullova dhomën e punës,
shpluhurosa librat e tua.

Mirupafshim, i dashur,
natën e mirë,
dhe më ndje,
nëse sot nuk të shkrova dot
një letër dashurie.

Shqip. F. Arapi

S E N T I M E N T E

Më telefonove s'ka pak,
shkruaja letra të zakonta,
firmosja shkresa të zakonta,
sigloja, rendja, mblihdhja,
korrigoja, gaboja.

Më telefonove s'ka pak,
ndeza një cigare
dhe të kujtova, të dëshërova.

Dhe u zgjova,
dhe më pushtoi gjumi sërish.

Shqip. I. Kadare

L U L E T

Lulet,
kur shprehen,
flasin gjuhën e dashurisë.

Lulet,
kur puthin,
kuptohet se nuk gjenden në botë
buzë më të mrekullishme.

Lulet,
kur e përhapin
erëndjen e tyre në pafundësi,
natyrës i japin mundësinë
të shprehë më të bukurën
buzëqeshje të saj.

Dhe një njeri që di ta ndiejë me ëmbëlsi
pastërtinë e tyre,
dhe një njeri që shkrihet thellë
me vezullimin e atyre ngjyrave,
ai njeri përulet e puth tokën
dhe bëhet NJERI.

NË LUGINËN TIME

Unë u vendosa në luginën time
dhe do të qëndroj,
i patundur
si një shkëmb,
për t'u përulur vetëm ndaj puthjeve të erës,
për t'u lagur vetëm nga buzëqeshja e shiut.

Natyra, dashnorja ime e zjarhtë edhe e përhershme,
do ta ndërtojë shtëpinë time,
kopshtin tim,
gëzimin tim.
Dhe ti do të rendësh për në krahët e mia,
do të rrokullisesh për toke,
do të jetosh prej tokës.

Shqip. D. Agolli

DHE KËSHTU, BIRI IM

Dhe kështu, biri im, ke sjellë agimin
dhe me agimin gjithë blerimin tënd,
diellin tënd të bekuar,
poezinë e hapave të tua të para,
dhe të vështrimit tënd kureshtar.

I brengosur, përreth vëreja
q'asgjë të mos na shqetësonte.
Dhe, kur buza jote e preku faqen time,
ky ish për ty kungimi i parë, o bir.

D E T A R Ë

Çdo largim, gjithnjë një «lamtumirë»
për gruan, për fëmijët dhe për miqtë.
Dhe maskimi
me një «mirupafshim»
është mashtrim i ëmbël për të gjithë.

Ujana¹⁾, dete, dimre me furtuna,
trajtën tuaj gjithnjë e pështjellin,
andaj dhe çdo kthim
është ngadhnjim,
dhe më gazmor na ngjan çdo përqafim

Ç'torturë — të jetosh dy dashuri
kaq të njëjta,
kaq të ndryshme.

Kaq ujë,
edhe një gji.

1) Ujanë = oqean.

SHTATORJA E BARDHË

Në Tiranë

Shtatorja e bardhë
vigjëlon për pushimin tuaj
të përkëdhelur nga bari.

Lule të kuqe rriten
dhe u dalin përpara të gjithëve
si një prroskë gjaku.

Varre dhe bar
përmallohen ndaj mermerit,
si dhe agimi.

Një ditë e re lind
në kujtime kraharorësh...

Mëma, vëllezër,
njerëz jo tuajtë
kanë ardhur te ju sot,

të vigjëlojnë për pushimin tuaj
tok me shtatoren e bardhë.

Shënim. Në këtë poezi, frymëzuar nga «Përmendorja e Dëshmorëve» në kodër të Tiranës, autori të rënë tanë partizanë i konsideron edhe si të rënë për idealin e Rezistencës antifashiste italiane, andaj në origjinal kësaj poezie i ka vënë titullin «Një shtatoreje martirësh për Italinë».

NJERIU I RI

Ufmë, zheg, zagushi,
djersë në fytyra.
Një flet për teatrin,
për jetën.

Ndiej shqetësim, ankth për takimin me ta.
Makina ndalet te hekurudha.
Më duket se po shkoj të pushkatohem,
se pushkë janë për mua pyetjet
e rinisë së Elbasanit,
që përreth më shtrëngohen
me shamitë në qafë,
me drapër-e-çekanët ndër sy.

Sa besim ka në gjestet e tyre të prera,
në fytyrat e mprehta të tyre!
Një ballulët dhe flokëpërdredhur

sulmon për vilat revizionistët.
Është Njeriu i Ri që shikoj:
studenti punëtor,
që i ndan tok me kazmën pushimet,
që ëndrrën e tij të lirisë
në zemër dhe në mendje e skalit.

Këtu: fushat e përqëndrimit janë kujtime,
roje, automatë: shfarosur,
hekuri, çeliku: lakuar,
njerzit trushtrydhur: tejflakur.

Përpara meje qëndrojnë
tre djem të rinj dhe tri vajza të reja.
Dhe unë kthehem në rininë time,
kujtoj shokët me gjokset përpara,
shokët e mi aq të gatshëm për ndeshje
edhe fizikisht me natyrën.

Ata më ftojnë papritur
që atje tok me ta të qëndroj,
të jetoj jetën e tyre të ashpër.

U them se më presin në Atdhe
malet e lavdisë së çlirimit,
dhe
në vend t'ulërimës
buzëqesh.

Ndalen ata për një çast
dhe sërishmi vazhdojnë bisedën:
djemtë dhe vajzat e reja.

Përshëndetemi
dhe ata më dhurojnë
shaminë që mbajnë në qafë,
atë me çekan dhe me drapër.

TË RINJ NË ELBASAN

Të rinj në Elbasan ëndërrojnë hekurudhën
dhe më flasin për Krishtin
e për kryqin, barrën e tij.
(Dhe qeshin).

Besimi i tyre i thellë
është buka, digat e reja,
kooperativat e gjelbëra,
fëmijët e shëndoshë që rendin luadheve.

Dhe për gjithë këto
ata kanë ngarkuar mbi shpatulla një barrë
dhe këtë e valëvitin si flamur.

K R U J A

Lamtumirë, Krujë mrekulli,
parzmore çelik ndaj Gjysmëhënës,
shporuar nga mijëra shpata
e gjithnjë e gjallë e besëfreskët.

Nga ti në zemrën time thitha
të gjithë zjarrin e një gostie
dhe një përçafje t'hajthme njerëzish,
thelbin e pastërtisë së kohës.

Koha këtu shihet ende në shtrat,
ku ethja i preu vrullin Birit;¹⁾
frotat e ndyra të rrethuesve
mend mbahen vetëm për disfata.

Këtu ende ngjan se përleshen
atje, kundrejt fortesës sate,

1) Birit (të Krujës) = Skënderbeut.

luadheve që nuk harrohen,
Skënder fatosi e Muhameti.

Dhe sot kushtrimi yt i netëve
më t'errëta të Shqipërisë
ngjan se bashkohet me stuhinë
për të tmerruar zullumçarët.

Plot koka deshën të të mposhtnin,
o Krujë, qytet mrekulli,
porse të gjithë ata u thyen
përballë mureve të tua.

Ti me rrënoja, blerim, armë,
me shembullin dhe qëndrimin tënd,
o Krujë e lashtë e besëfreskët,
mesazh që s'vdes për gjithë je.

I KËNDOJNË PUNËS DHE REVOLUCIONIT

Në Vaun e Dejës

Njerëz e krahë
i këndojnë punës dhe revolucionit.

Rrjedh ujët mes zhurmës kazmore
dhe zhurkllimës së zhavorrit përplasur përtokë.

Njerëzit përulen përpara entuziazmit
dhe djersës së një populli,
që jeton turnin e vet heroik.

Sy malësorësh
të zbritur në fushë,
t'i ndërrojnë fytyrën një vendi
dhe me bukurshkrim të lodhin sytë në mbrëmje.
Duar me kallo, të gjakosura,
të shtrëngojnë dorën, fort të përqafojnë.

Besojnë dhe të ftojnë të besosh
në sytë e tyre, në gjakun e tyre.

Takimi me njerëz kaq të gjallë
është takimi më i rrallë.

Janë të lumtur si dashnorët që puthin
dashnoren për herë të parë.
Në të ti gjen për një çast
ngadhnjimin mbi botën...
Xhaketat fluturojnë
të ngopura me djersë.

Shtangem si gur, pushtuar nga hareja.

SHKODRËS SË BLERTË

Shkodër, rrafshinë blerimi,
fytyra jote — buisje rizgjimi,
mbulon vezullime dritarkash të shkreta,
limere vështrimesh të ngurta.

Te ti, sfilitur nga ushtat, mbaruan
hordhitë e barbarëve
dhe gjaku i fshiu litanitë.

Në ish-katedralen po lozin të rinjtë
dhe topi përhidhet ndër kohët.
E sotmja jote është dëshmi varrimi
për shenjtorët, të djeshmen mistike,
që sot na e kujton vetëm qiellzana.¹⁾
Me mendje e çava tavanin
dhe pashë hapësirat qiellore.

1) Qiellzanë — tavan

SHTËPI PUSHIMI NË VLORË

Të vendosura në shkëmb,
në vezullime dritash,
po bien çangat e pushimit.

Lëvizja e llërëve të përveshura,
e kazmave,
që hapin brazda,
në ajrin akull ndërpritet.

Tashti të duhet qetësia
ty,
dritandezës
i sheshit të madh të jetës.
Dhe ti përkëdhel kitarën
me duar ku ndihet fabrika,
çeliku,
toka.
Duar të pastra në qiellin e kthjellët

ngrihen për t'i prekur krahët
gruas në vallëzim,
gruas që vallëzon
dhe buzëqesh.

Dhe në ajrin,
larg punës,
prap ndihet po puna,
dhe mushkëritë mbushen plot me thënien për
punën
të shkruar në mal.

Thotë Enver Hoxha: «Puna është zot i jetës!»

Dhe xhami e kisha vajtojnë.
Buzëqeshin punëtorët në Shëtitoren e Porto-
kalleve mbrëmjes në Vlorë.

SHËTITORJA E PORTOKALLEVE

Në Vlorë

Shëtisin punëtorët
në Shëtitoresh e Portokalleve,
ndërsa valët shushurit,
zëra njerëzish përmbytin
xhami e kisha heshtjerënda.

Hija e Ismail Qemalit
mbush qiellin me të bëmet e tij,
dhe, kur vjen mbrëmja,
Skënderbeu kalorës i yjeve vigjëlon.

Unë eci dhe përpara meje
prin një Enver Hoxhë vigan.

TË MARRËSH FRYMË

Të marrësh frymë, është vorbullim e zbutje ajri,
viganizim dhe fryrje e dheut;
të ndihemi të gjallë edhe të vdesim,
dhe mbi çdo gjë: të duam dhe të urrejmë!

T A F R A U T

Në Marok

Lemë pallatin e mbretit
dhe shpejt ne arrijmë në kolibet.

Udha është aq e shkurtër,
sa nga hareja
në dhembje
kalimi nuk duket i pamundur.

Të gjithë i kanë hapur dyert:
nga pullazet
gra e fëmijë
po na vështrojnë të drojtur.

Për «mirseardhje»
na çojnë fëmijët
si degë ulliri.
Në Tafraut
a ka ende vend
për vrasje, grabitje, shkatërrime?

Pak kolibe prej balte,
mjaft buzëqeshje fëmijësh.

Përmbi hurma
dhitë ngjiten,
sikur kërkojnë të fshihen;
djemtë me lodrat e njëjta
kërkojnë lëmshën nga ne —
kolonizatorët.

Fodullë,
me duart ndër xhepa,
ne rendim duke menduar
kur nipave do t'u flasim
sa këtu pamë edhe dëgjuam.

Ti, arab, që ke studjuar në Sorbonë
më vëren.
Edhe unë të shikoj
dhe të pyes
përse braktise Paris, Senë, kabare?
Ti më vëren
dhe mundohesh të kuptosh,
edhe të kuptohesh.
Dhe tashti
po më tregon
dhitë, kolibet, fëmijët.
Për to u ktheve
edhe jep kushttrim.

T O K A

Toka atje
është gati të presë gjakun e njerëzve,
ta ndërrojë në bar, në pemë që nuk harrojnë.

Dhe sërish
njerëz-bisha do të bëjnë shoshë koka.

Do të vallëzojë urrejtja
mbi pumat¹⁾, hienat, shpendët grabitqarë.

Do të buçasë përroi
me vrull e me dëshira

dhe ujët
do ta zbrazë mbi plisat e freskët,
mbi luleshqerrat e njoma, mbi vjollcat. . .

1) Puma = luanë të Amerikës; këtu: sundimtarët gjakatarë.

Një rreth i stërmadh
nesër do të bëhet
dhe gjithë
do të mbërthehen dorë më dorë.

Dhe njeriu
do ta shikojë në sy gruan e vet,
dhe gjithë
do të vallëzojnë me kryet lart drejt qiellit.

KONGRES NDËR NE

Një grumbull njerëzish fjalë-tepër-matur,
zbrazësirë e ndrydhur që shpërthen:

idealet —

ndotur nga kompromisi:

fytyra të mëdyshta,

por edhe të vendosta,

llafazanë të përçartur të pafalshëm,

gojëkyçur gjithaq të pafalshëm;

fjalë lumë, fjalë, fjalë:

analiza, parashtresa, sinteza.

Dhe, më në fund —

salla që boshatiset,

ashtu si shishja e verës.

SHPRESA

fragment

Tashti afshi i tokës
kërkon sërishmi ujë.

Edhe burimi
i bën thirrje krejt dëborës,
që ndër male
po shkrihet prej diellit.

Dhe lëfyti i burimit
vërvit më me forcë ujët,
dhe fshin rrjetat e merimangave
në të gjitha zemrat e botës,
që i lirë të rritesh, gjelbërim.

B R E Z A T

(fragment)

– Dhe tashti, o bir, çfarë do të bëjmë:
shpirti yt është i blertë si luadhet,
apo i verdhë si ari?

– E flaka tej arin, o atë,
edhe kam mbetur mbushur gjelbërim.
Më rrahën, o atë,
se isha plot përplot me gjelbërim.

– Na, merr arin, o bir,
dhe shumëzoje!

– Nuk mundem, atë,
jam plot përplot blerim e plagë.

– Ti s'je dinak, o biri im,
kurrë nuk ke qenë dinak.

FESTA E DIELLIT

Në Kastiljonçelo

E lë qytetin e errët
dhe ngjitem
lart,
nëpër blerim;
lodhja më shtrëngon zemrën,
djersa rrjedh dhe sytë m'i verbon;
shtegu është i ashpër dhe shkëmbor,
siç është zemra ime;
drurët dhe flladi
më ndihmojnë dhe më nxitin.
Thuajse kam arritur
në majë të malit,
që prej këndeje deti është krejt ar:
është festa e diellit.

NË KËTË GJI DETI

Qielli është i kuq këtë mbrëmje
në këtë gji deti:
sikur të ishin bashkuar në atë ngjyrë
gjithë shpresat e njerëzve;
sikur të gjenin përdëllim në atë dritë
gjithë zhgënjimet e njerëzve;
sikur të ishte hapur një strehim në shkëmb
për brengën e secilit prej nesh.

Deti është i përhirët këtë mbrëmje
në këtë gji deti:
sikur të ish venitur nga mjerimet tona
bardhësia e valëve;
sikur të mos ishte e mjaftë
ngrohtësia e tokës
për të na bërë ta ndiejmë veten të gjallë.

Muzika është e ëmbël këtë mbrëmje
në këtë gji deti;

sikur të mos shprehej dashuria
veçse me përmallim;
sikur të mos ishin të puthurat
veçse përkëdhelje buzësh;
sikur qielli dhe toka të përqafoheshin,
për të na thënë se nuk duhet t'u bëjmë bisht
gëzimeve dhe hidhërimeve të jetës.

TRYEZA E LËNDËS

Faqe

Parathënie	3
Një heroi	13
Tashti jam në anët e mia	15
Dhurata për Rezistencën	17
Kasolle	19
Për një çast	20
Grabujim	21
Të pamposhturit	23
Flakadanë	25
Kallëz gruri	27
Fitimtarët	29
Një miku partizan	30
I braktisur	31
Ujdhesa e Zambakut	33
Atje lart	35
Stinë	36
Male	37
Bërthamë vreri	39
Melankoli	41
Në Livorno	42

Në mal	44
Ti	45
Qieł korriku	46
Tokë e kuqe	47
Udhëtimi	49
Kulla	51
Jeta ime	52
Ty të pashë	54
Këngë mbrëmjeje	55
Kur më puth dashuria	57
Për gjithë jetën	58
Një letër	59
Sentimente	60
Lulet	61
Në luginën time	63
Dhe kështu, biri im	64
Detarë	65
Shtatorja e bardhë	66
Njeriu i ri	68
Të rinj në Elbasan	71
Kruja	72
I këndojnë Punës dhe Revolucionit	74
Shkodrës së blertë	76
Shtëpi pushimi në Vlorë	77
Shëtitorja e Portokalleve	79
Të marrësh frymë	80
Tafraut	81
Toka	83
Kongres ndër ne	85
Shpresa	86
Brezat	87
Festa e diellit	88
Në këtë gji deti	89